



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



EKSTRAKTI PROCESVERBALIT

të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 26.06.2019,
duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Agim Gashi, Jeta Rafuna, Eman Rrahmani, Fadil Gashi, Genc Sherifi dhe Egzon Azemi.

Munguan: Blerand Stavileci, Vala Peshku, Halim Halimi she Sami Boroci.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Arta Sylejmani, përfaqësuese e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Mentor Zeka, përfaqësues nga OSCE-ja dhe Fahri Krasniqi, përfaqësues nga "Hendikos".

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta, kryesues**, me këtë

REND DITE:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Gëzim (Sabri) Thaçit;
3. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Jusuf (Shaban) Qyqallës;
4. Propozimvendimi për miratimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje";
5. Propozimvendimi për lënie në shqyrtim publik të projektdokumentit për revidimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën "Mati 1", vazhdimi i rrugës "B" (Bahri Fazliu), pjesa jugore;
6. Propozimvendimi për dhënie në shfrytëzim të stadiumit të futbollit në Hajvali Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK);
7. Të ndryshme.

Faqe 1 nga 5

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, Osman Bllaca lidhur me pikën e gjashtë të rendit të ditës, tha se nuk ka ardhur kërkesa nga ana e Ministrisë së Kulturës, gjegjësisht ministrit Kujtim Gashi. Materiali është i gatshëm, mirëpo pa këtë kërkesë nuk mund ta iniciojmë. Është fjala për dhënien në shfrytëzim të stadiumit të futbollit në Hajvali, kërkesë që ka ardhur nga Federata e Futbollit të Kosovës, ku UEFA ka për qëllim të investojë në këtë stadium në Hajvali, por prona duhet t'i jepet në shfrytëzim Federatës së Futbollit të Kosovës, e që ende nuk është gati dokumentacioni i nevojshëm, andaj shpresojmë që deri në mbledhjen e Kuvendit të kompletohet.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Gëzim (Sabri) Thaçit.

Eman Rrahmani u shpreh se pasi që nuk i kemi drejtorët prezent në takim, për të na dhënë shpjegime lidhur me këtë pikë, nuk kemi si të vazhdojmë me diskutime.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Gëzim (Sabri) Thaçit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tretë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Jusuf (Shaban) Qyqallës.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Jusuf (Shaban) Qyqallës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e katërt

Propozimvendimi për miratimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje.

Eman Rrahmani tha se meqë materiali ka ardhur tani, nuk kemi çka të komentojmë, kështu që i lëmë komentimet për Kuvend, sepse nuk e kemi analizuar materialin.

Genc Bashota dha sqarime, duke cekur se ky propozimvendim ka kaluar në tetor të vitit të kaluar si vendim për revidim, pastaj ka kaluar për diskutim publik. Diskutimi publik është kryer, nuk ka pasur asnjë koment, kështu që nuk kemi pasur arsye as me formuar komisionin, andaj e kemi sjellë opsionin final, ashtu siç ka qenë, pa asnjë ndryshim.

Eman Rrahmani kërkoi që për mbledhje të Kuvendit, si informacion shtesë me pasur se ku janë mbajtur dëgjimet publike dhe njoftimet kurë janë bërë.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për miratimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje" dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e pestë

Propozimvendimi për lënie në shqyrtim publik të projektdokumentit për revidimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën "Mati 1", vazhdimi i rrugës "B" (Bahri Fazliu), pjesa jugore.

Genc Bashota dha sqarime, duke cekur se edhe kjo ka kaluar në Kuvendin e Komunës para një kohe, vazhdimi i rrugës "B" dhe kolektori. Ne si Drejtori e Planifikimit e kemi hartuar së bashku me Urbanizmin këtë pjesën e Rrugës "B", ndërsa kolektorin ende nuk kemi mundur. Po ashtu, kemi trajtuar një zonë prej 4.12 hektarë, ku ideja ka qenë me realizuar rrugën, atë te rruga "B", në anën e djathtë, ku është gjelbërimi, me shkuar me koeficiente, për të mundur me i shpronësuar këta banorë me koeficiente. Për këtë Plan është punuar seriozisht dhe një kohë të gjatë. Po ashtu, kemi arritur mes tjerash me inkuadruar edhe një çerdhe dhe një qendër kulturore në atë hapësirë. Ky propozimvendim del në diskutim publik një muaj, ku do të kemi mundësi t'i shohim komentet e banorëve se pajtohen apo nuk pajtohen me këtë.

Agim Gashi theksoi se kjo është pjesa ku fillon rruga "B", ana jugore, e vazhdon edhe përgjatë përroskës dhe shkon deri në kryqëzimin me vijën për rrugën "A".

Eman Rrahmani tha se qëndrimi ynë në këtë aspekt është i ditur. Ne mendojmë se janë duke e stagnuar Hartën zonale dhe Planin zhvillimor. Unë nuk po e kuptoj arsyen se pse nuk po punohet me e përfunduar komplet Hartën zonale, pasi që është premtuar që ka me përfunduar para shtatorit, dhe ky Plan nuk besoj që mund të përfundojë para shtatorit, nuk ka asnjë mundësi

ligjore as teknike me përfunduar në bazë të këtyre çka po na i sillni ju këtu. Nuk e di çka është duke u punuar brenda për brenda Hartës zonale, në qoftë se na e sillni në çdo mbledhje nga një plan të hollësishëm për një lagje! T'u hyjmë të paktën të gjitha lagjeve t'ua bëjmë planet që nuk i kanë dhe të zhvillohen. Kështu jemi duke punuar në disa lagje e disa lagje duke i bllokuar!

Genc Bashota tha se e kemi diskutuar disa herë se çështja e këtij Plani këtu është prioritet i madh, sepse ne e kemi një lagje që nuk po mundemi me realizuar rrugën "A" dhe atë pjesën te kolektori, do të thotë me mundur sa më shpejtë me krye këtë çështje e me i hapur rrugë ndërtimit të rrugës, kjo është prioritet.

Agim Gashi pyeti se a ka hapësira për shpronësim.

Eman Rrahmani pyeti se a ka mundësi me u kompensuar kjo me koeficient.

Genc Bashota bëri të ditur se kjo do të bëhet me kompensim koeficienti.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për lënie në shqyrtim publik të projekt dokumentit për revidimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën "Mati 1", vazhdimi i rrugës "B" (Bahri Fazliu), pjesa jugore, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të stadiumit të futbollit në Hajvali Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK).

Agim Kuleta, kryesues, tha se për këtë pikë nuk ka kërkesë, ashtu siç na informoi zotëri Bllaca, kështu që besoj se deri në mbledhjen e Kuvendit do të kompletohet.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të stadiumit të futbollit në Hajvali Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e shtatë

Të ndryshme.


Egzon Azemi tha se ne e dimë që e kemi votuar bashkërisht Rregulloren për tatimin e tokave të cilat nuk punohen, mirëpo për t'u u realizuar kjo, ne fillimisht është dashtë me ua mundësuar një lloj infrastrukture bazë. Në disa fshatra të Prishtinës ka ankesa të qytetarëve se nuk po kërkojnë asfaltim të atyre rrugicave, për shembull në fshatin Keçekollë ishin 34 hektarë tokë punuese të cilat janë të pashfrytëzueshme, pikërisht për shkak që rruga është e pakalueshme. Ata nuk po kërkojnë as asfalt, as kubze, por po kërkojnë mjete të cilat e zgjerojnë rrugën dhe e largojnë dheun që është bartur nga uji e që është bërë pjesë e pakalueshme, ku as me traktor nuk mund të kalohet. Përveç tokës punuese, aty lart ishin edhe varrezat e fshatit, andaj besoj se një temë e tillë është dashtë të diskutohet edhe në Kuvendin e Komunës, se është e padrejtë me tatuar më shumë një banorë që ka një tokë punuese atje, e që ai nuk ka asnjë mundësi me punuar atë tokë pa rrugë, sepse pa pasur qasje te prona nuk është e mundur me u punuar toka.

Eman Rrahmani kërkoi formimin e një komisioni, i cili del dhe i vlerëson rrugët e fshatrave në përgjithësi. Nuk kemi të drejtë me i ngarkuar me tatim për diçka ku nuk mund të kenë qasje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30.

**Procesmbajtësja
Shyhrete Islami**

**Kryesuesi i Komitetit:
Agim Kuleta**

A handwritten signature in blue ink is written over a circular official stamp. The stamp contains the text "KOMITETI I SHYHRETE ISLAMI" and "PRISTINA" around the perimeter, with a central emblem.